

STATUT I SHOQERISE

MONUN BOUTIQUE HOTEL

SH.P.K

Ky Statut do te konsiderohet se inkoporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise ,organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, me 27/01/2025, personat e mëposhtem :

Arbër Çepani, atësia Çlirim, amësia Evgjeni, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Myslym Shyri; ND. 75; H. 41; Ap. 12; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7 1023; Tiranë, lindur më 08/05/1987, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 03151281 dhe nr. Personal I70508090S, mbështetur : Në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" Të Plotësuar, Në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka themeluar nje Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me emertimin "Monun Boutique Hotel" shpk, (me poshtë e quajtur "Shoqëria")

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi

Më 27 Janar 2025 është krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregëtar "Monun Boutique Hotel" shpk.

Neni 2

Objekti

Objekti i veprimtarisë.


Shoqëria do të ushtrojë aktivitet privat si më poshtë:

Aktivitet në fushën e hapjes dhe menaxhimi i hoteleve e godinave dhe ambjenteve ne te cilat ushtrohet aktivitet hotelier, Hapja dhe menaxhimi i sallave te konferencave ne kuader te aktivitetit hotelier.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërise do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.



Neni 4

Sella

Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr 15, Njesia Bashklake Nr 2, Nr pasurisë 2/466, ZK 816, vol 26, fq 170 Tiranë.

Me Vendim të Administratorit, Shoqëria mund të celë degë dhe /ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) lekë dhe është i ndare në 1 (një) kuotë.

Pjesëmarrja e themeluesit është sipas kontributit në para si më poshtë :

1-Ortaku Arbër Çepani zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 100.000 lekë e barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 6


Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet ose zvogëlohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

-kontributit në kapitalin e shoqërisë;

-shitblerjes;

-trashëgimisë;

-dhurimit;

-cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitali themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitali themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :


a.Përcaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë;

b.Ndryshimet e statutit ;

c.Emërimin e shkarkimin e administratorëve ;

ç.Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar ;

d.Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat C dhe të kësaj pike ;



dh.Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë ;

e.Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë ;

ë.Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit ;

f.Pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre ;

g.Përfaqësimin e shoqërise në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve ;

gj.Riorganizimin dhe prishjen e shoqërise ;

h.miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë ;

i.shperndan fitimet vjetore

j.çështje të tjera të parashikuara me ligj ose statut.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme , në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër ose nga një person i tretë.

Neni 9

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose ,nëse parashikohet nga statuti , me njoftim nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi me shkresë ose mesazh duhet të përmbajë vendin,datën,orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dergohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë para datës se parashikur për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 per qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje , të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të

votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë ,apo mjete elektronike ,sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të rregjistruar, shpërndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqërise.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë votash të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si : përcaktimi I politikave tregtare të shoqërise ; emërimin e administratorëve ; emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar ; përcaktimin e shpërblimeve ; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; perfaqësimin në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve ; miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 12

Përfshirja nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë te drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për : vlerësimin e veprimtarisë së tij ; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij ; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria ; dhënien ose jo te përfitimive te reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi si edhe ortaku, të cilin përfaqëson.


Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorët shoqërisë. Afati I emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratorë e shoqërise do te jetë:

Znj Orjona Çollaku, shtetase shqiptar, lindur më 13.10.2005 në Korçë, banues në Tiranë, Porodinë, Njësia Administrative Bulgarec, Korçë me nr ID K56013028J, ,madhor e me zotësi të plotë për të vepruar,pa kufizime te kompetencat e administrimit.



Administratori i shoqërisë vepron si organ i pavarur . Firmos dhe përfaqëson shoqërinë në mënyrë të pavarur ndaj të tretëve (banka, institucione financiare, institucione shtetërore dhe struktura të ngjashme).

Neni 14 **Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakët i vetëm;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,;
- Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij. Shoëqria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është më provë e mjaftueshme.

Neni 15

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortakët që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 3 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administrator detyrohet:



1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në

KREU IV

Viti Financiar-ekspertët

Neni 16

Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të biznesit dhe mbyllet në 31 dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Ekspteri ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare së shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij në rastet kur ai është i ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorezojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

Prishja – Riorganizimi i Shoqërise

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të bëhet në cdo kohë : kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj ; me vendim të asamblesë së Ortakëve ; me hapjen e procedurave të falimentimit ; në përputhje me pikën 3 në nenit 43 të ligjit 9723/2007 ; me vendim të gjykatës.

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar i apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i Shoqërise, bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.

Neni 20

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, të Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky statut u hartua në gjuhën shqipe dhe, pasi u lexua dhe kuptua, u nënshkrua nga të dy ortakët si vijon :

ORTAKËT

TË SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR

“Monun Boutique Hotel” shpk

Arbër Çepani

